



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM
Nr.43, datë 20.09.2019

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME HIMARË SH.A.

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (**VKM nr.958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 20.09.2019 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e projekt vendimit "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Himarë sh.a.",

Vëren se:

1. Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Himarë (**UK Himarë**) me shkresën nr. 334 prot. datë 28.08.2019 ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për licencim për shkak të mbarimit të afatit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Himarë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit.
3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:
 - a) Shoqëria UK Himarë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për 20 852 banorë të Bashkisë Himarë si më poshtë:

- Zona e shërbimit me furnizim me ujë dhe kanalizime nga shoqëria UK Himarë

Nr.	Njësitë administrative të Bashkisë Himarë	Popullsia në juridiksion	Popullsia e shërbyer
1	Himarë	13 488	12 089
2	Lukovë	9 477	8 763
3	Horë - Vranisht	3 697	0
TOTALI		26 662 banorë	20 852 banorë

Shënim: UK Himarë nuk ofron shërbim në njësinë administrative Horë-Vranisht.

- b) Drejtuese teknike e shoqërisë znj. Fabjola Duro zotëron diplomë Master në Inxhinieri Mjedisi, profili Trajtim Uji, datë 07.12.2018.
4. ERRU në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Himarë, të:
- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;
- b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” të ndryshuar, (**ligji nr. 9121**) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;
- c) ERRU, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë UK Himarë rekomandon:
- Shoqëria UK Himarë duhet të punojë në drejtim të zgjerimit të zonës së shërbimit në të gjithë bashkinë Himarë.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Himarë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Himarë sh.a me NUIS L26328203D në kategoritë:
 - a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik
 - b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura

2. Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Himarë sh.a autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:
- a) Drejtues Ligjor – Andrea Goro
 - b) Drejtuese Teknike – Fabjola Çaushaj (Duro)
3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Himarë sh.a është:
- Bashkia Himarë: Njësitë Administrative Himarë
Lukovë
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 vjeçare.
5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Himarë sh.a detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
6. Ngarkohet Drejtoria Teknike Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Himarë sh.a për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani